

L I G J

Nr.7853, date 29.7.1994

PER DISA SHTESA NE LIGJIN NR.7746, DATE 28.7.1993 "PER HIDROKARBURET (KERKIMI DHE PRODHIMI)"

Ne mbeshtetje te nenit 16 te Ligjit Nr.7491, date 29.4.1991 "Per Dispozitat Kryesore Kushtetutese", me propozimin e Keshillit te Ministrave,

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

VENDOSI:

Neni 1

Ne ligjin Nr.7746, date 28.7.1993, ne nenin 12, pas pikes 2 shtohet nje paragraf me kete permbajtje:

Ne lidhje me marreveshjen e mesiperme, qe do te quhet "Marreveshja Albpetrol":

a) Marreveshja Albpetrol do te jete e vlefshme dhe e detyrueshme ne perputhje me termat e saj dhe Ministria i jep licence Albpetrolit sic permendet atje (ne marreveshje).

Nje Licence do ta autorizoj Albpetrolin, sipas termave dhe kushteve te percaktuara ne te per te kerkuar, zhvilluar dhe prodhuar hidrokarbure ne zonen e kontrates dhe, ne te kundert, te vazhdoje operacionet hidrokarbure ne zonen e kontrates. Te gjitha dispozitat e ketij ligji, te zbatuar ne ose ne lidhje me Marreveshjen Hidrokarbure do te zbatohen ne dhe ne lidhje me nje licence e cila do te kete fuqi si kontrate.

b) Pa paragjykuar karakterin e pergjithshem te paragrafit (a) te mesiperm, nje licence mund ta lejoje Albpetrolin, me pelqimin e Ministrise te transferoje dhe te kaloje te gjitha ose nje pjese te te drejtave , titullimit dhe interesit te tij ne te nje personi juridik, vendas a te huaj, ose institucioni nderkombetar financiar, me te cilin ai deshiron te bashkepunoje per qellimet e permendura ne marreveshjen Albpetrol.

c) Marreveshja Albpetrol autorizon Albpetrolin te hyje ne Marreveshje Hidrokarbure, duke autorizuar personin ose institucionin perkates, sipas termave dhe kushteve te percaktuara ne te, te kerkoje, zhvilloje e prodhoje hidrokarbure ne zonen e kontrates dhe, ne te kundert, te vazhdoje operacionet hidrokarbure ne zonen e kontrates. Nje marreveshje e tille Hidrokarbure, e cila nuk duhet te bjere ne kundershtrim me termat e licences perkatese, do te jete Marreveshja Hidrokarbure lidhur sipas ketij ligji.

Neni 2

Ne shtojcen bashkelidhur ligjit, pas pikes 5, shtohet nje paragraf me kete permbajtje:

"Marreveshja per autorizimin e kryerjes se operacioneve hidrokarbure, e lidhur me 26 Korrik 1993 ndermjet Ministrise se Industrise, Burimeve Minerare dhe Energjitike (sot Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjitike) dhe Albpetrol (Bashkesia Ekonomike e Naftes dhe Gazit).

Neni 3

Ky ligj hyn ne fuqi menjehere.

**Shpallur me Dekretin Nr.900, date 4.8.1994 te presidentit te Republikes se Shqiperise,
Sali Berisha.**